



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2356, datë 27.09.2013

Për

Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelcom sh.a dhe Plus Communication sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Plus Communication sh.a. drejt Albtelcom sh.a.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 27.09.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelcom sh.a dhe Plus Communication sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Plus Communication sh.a. drejt Albtelcom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 87 pika 5 dhe 9, neni 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**), i ndryshuar;
2. Neni 46, 66 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore e Portabilitetit të Numrit, nr. 13, datë 16.04.2010, e ndryshuar, Neni 4 pika 1, Neni 5 pika 1, Neni 6 pika 1, Neni 12 pika 2, Neni 15 pika 2 dhe 3, Neni 17 pika 2;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Albtelecom sh.a., më nr. 4571 Prot datë 26.07.2013, “Në lidhje me kërkesat e fundit të refuzuara dhe mbajtura pezull nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., më nr.4605 Port datë 26.07.2013, “Mbi proceset e portimit të pezulluara nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/1 Prot datë 30.07.2013, “Mbi proceset e portimit me Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/2 Prot datë 01.08.2013, “Mbi procesin e portimit me Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/3 Prot. datë 01.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/4 Prot. datë 02.08.2013, “Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/5 Prot. datë 05.08.2013, “Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/6 Prot. datë 06.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/7 Prot. datë 12.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/8 Prot. datë 13.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/9 Prot. datë 15.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/10 Prot. datë 15.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4955 Prot. datë 19.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/11 Prot. datë 26.08.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/12 Prot. datë 28.08.2013, “ Mbi mos zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për portabilitetin e numrit nga operatori Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/13 Prot. datë 29.08.2013, “ Mbi mos zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për portabilitetin e numrit nga operatori Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/14 Prot. datë 30.08.2013, “ Mbi mos zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për portabilitetin e numrit nga operatori Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/15 Prot. datë 03.09.2013, “ Mbi pezullimin e procesit të portabilitetit nga Plus”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a., nr. 4605/17 Prot. datë 10.09.2013, “ Kërkes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me pezullimin e procesit të portabilitetit të numrit nga operatori Plus”;

- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**), si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Sipërmarrësi Altelecom sh.a, me shkresën nr. 4605/17 Prot., datë 10.09.2013, (nr. 1308/19 Prot. i AKEP, datë 11.09.2013) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje në lidhje me pezullimin e procesit të portabilitetit të numrit nga operatori Plus”, dhe Shtojcën 1 të Rregullores “Për procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes” sqaron dhe kërkon:

1. Altelecom sh.a. kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me operatorin Plus Communication sh.a.për procesin e portimit të institucioneve, KESH (Aparati), HEC Vau i Dejës, KESH Koman, Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a, Xhavite Zyla PF, të cilat janë ende të pa portuara në rrjetin Altelecom, si dhe marrjen e masave ndaj Plus për mos zbatimin e Rregullores së Portabilitetit të numrit dhe portimin jashtë afateve të përcaktuara në këtë rregullore të subjekteve: Beton Ekspres sh.p.k, Drejtoria e Shëndetit Publik Kavajë, Ilad sh.p.k, Spitali Lushnje, MTKRS, Dulati AL sh.p.k, Hysi sh.p.k, Qani Shini PF, Poliklinika Nr.10, Qendra Shëndetësore Kushovë, Mikael-Grup sh.p.k.
2. Altelecom sh.a. sqaron se i ka dërguar kërkesë kompanisë Plus për të portua subjektin KESH në datë 25.07.2013, por nga kompania Plus nuk ka pasur asnjë reagim në lidhje me këtë kërkesë duke shkakëtura mos portimin e institucionit në rrjetin Altelecom. Për rrjedhojë subjekti është paisur me linja të reja. Nga Plus kemi patur pezullime në formë automatike për çdo kërkesë të subjekteve të ndryshme që kërkonin portimin nga rrjeti Plus drejt rrjetit Altelecom duke kundërshtuar çdo afat dhe kusht të përcaktuar nga Rregullorja e Portimit të Numrit.
3. Altelecom sh.a ka përcjellë të gjitha këto problematika në shkresat zyrtare të drejtuara AKEP dhe Plus. Gjithashtu nga AKEP janë realizuar takime të posaçme, dhe i është kërkuar Plus nëpërmjet komunikimeve elektronike mes palëve, zgjidhjen sa më të shpejt të rasteve dhe zbatimin e Rregullores së Portabilitetit në fuqi
4. Altelecom sqaron se i ka kërkuar AKEP verifikimin e zbatimit të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni, për operatorin Plus duke e bazuar në prova dhe fakte konkrete dërguar AKEP. Sipas Altelecom operatori Plus ka vazhduar të mos zbatojë afatet dhe kushtet e zbatimit të portabilitetit të numrave të përcaktuar nga Rregullorja e Portabilitetit. Altelecom pretendon se kjo situatë ka sjell dëme të konsiderueshme jo vetëm në dëmtimin e imazhit të tij për sa i përket ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit ndaj pajtimtarit por edhe duke krijuar kosto shtesë operationale që nuk do të ishin çdo operator do të zbatonte kuadrin rregullator në fuqi për këtë proces.
5. Altelecom sqaron se ka bërë përpjekje maksimale për të zgjidhur mosmarrëveshjen por nga kompania Plus nuk ka pasur asnjë bashkëpunim, përkundrazi procesi është bllokuar në dëm të pajtimtarëve.
6. Sipas Altelecom vlerësohet se mosmarrëveshja dhe mosrealizimi i portimit të subjekteve apo vonesa gjatë procesit, i kanë shkakëtuar një dëm total 5,308,801 Lek Altelecom. Vlerësimi i kësaj shume është bazuar në:

1. Fitimin e munguar nga mosrealizimi i terminimit të trafikut në Albtelecom Mobile;
 2. Fitimin e munguar nga mosrealizimi i trafikut si abonent i Albtelecom Mobile;
 3. Kosot operative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 4. Dëmtim/Prishje të imazhit të kompanisë;
7. Albtelecom kërkon që AKEP të zbatojë Rreguloren e Portabilitetit dhe të lëshojë urdhër për Plus për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për portimin e të gjitha numrave të pezulluara, dhe marrjen e masave ndaj Plus për mos zbatimin e portabilitetit të numrit për pajtimtarët e tij.
8. Albtelecom këkon që AKEP:
1. Lëshim i urdhrit me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP për detyrimin e Plus për të portuar gjithë numrat e subjekteve të Mësipërm në Rrjetim Albtelecom
 2. Kompensim i dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar që i është shkaktuar Albtelecom si pasojë e mosmarrëveshjes si dhe vonesave të portimit të subjekteve, në kundërshtime me Rregulloren e Portabilitetit të Numrit dhe legjislacionit në fuqi.
9. AKEP, më datat 30.05.2013, 29.07.2013, 28.08.2013 zhvilluan disa seanca me palët në lidhje me problemet e krijuara midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a.. në rritjen e numrit të mos pranimeve të kërkesave për bartje. Palët në këto takim mbajtën të njëjtin qëndrim, të parashtruar në pretendimet e tyre.
10. Në përfundim, duke qenë se Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a. megjithë përpjekjet e bëra mes tyre edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për portimin e numrave të pajtimtarëve nga Plus drejt Albtelecom, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike, në zbatim të nenit 88, 120 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullorja nr.13 datë 16.04.2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në:

- Pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Nenin 46 e vijues të “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;
- Rregullore e Portabilitetit të Numrit, nr. 13, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication sh.a. në lidhje me procesin e portimit të numrave nga Plus Communication sh.a drejt Albtelecom sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Shefqet Meda Kryetar
 - Donald Shtrepi Anëtar
 - Dritan Malaj Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Ded Jakaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a. dhe Plus Communication për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**